

25 Korrik 2014

**Fjale pershendetese e Drejtorit te IGJEUM,
Prof. Fatos Hoxhaj**

Projekti “BalkanGeoNet” Ka si objektiv themelor perfshirjen e vendeve te Ballkanit ne Iniciativat Globale te Vrojtimeve te Tokes (Inclusion of Balkan Countries into Global Earth Observation Initiatives).

Instituti i Gjeoshkencave, partner ne kete projekt, aplikoi ne fillim te vitit 2010 per te qene partner dhe Universiteti Politeknik i dha te gjithë mbeshtetjen e nevojshme. Kjo pasi ne jemi te vetedijshem se përfshirja e të gjitha vendeve të Ballkanit në Organizatat Nderkometare te Vrojtimeve te Tokes është i një rëndësie të madhe. Ne te njeiten kohe eshte e qarte se vetëm një kornizë gjithëpërfshirëse e EO (Earth Observations) mund të çojë në kuptim më të mirë dhe me inteligjent per shfrytëzimin e burimeve mjedisore, rritjen e cilësisë së jetës dhe ne nje zhvillim me te shpejtë ekonomik te cdo vendi dhe te gjithë vendeve te teresi. Rëndësia dhe përfitimet nga pjesëmarrja në iniciativat globale te EO-ve janë tashmë njohura nga disa vende të Ballkanit. Megjithatë, fatkeqesisht, një numër i madh i vendeve të Ballkanit nuk janë ende anëtarë të ketyre organizatave perfshi edhe Shqiperine.

Ky projekt synon të identifikojë ofruesit dhe perdoruesit e te dhenave EO ekzistuese në rajonin e gjerë të Ballkanit, për të përcaktuar statusin e tyre, potencialet dhe nevojat, dhe për të koordinuar lojtarët e EO duke krijuar rrjetet ndermjet tyre. Projekti synon gjithashtu te realizoje një analizë te gjerë te boshllëqeve dhe aktiviteteteve shtese te EO per te permbushur nevojat e perdoruesve me theks te vecante per vendet e Ballkanit.

Projekti ka 16 partnere nga (Serbia, Austria, Greqia, Kroacia, Hungaria, Belgjika, Rumania, Bullgaria, Bosna dhe Hercegovina, Mali i Zi, Shqiperia, Maqedonia)

Sic shikohet partnere ne kete projekt jane institucione shkencore nga te gjitha vendet e Ballkanit. Ne projekt jane perfshire edhe pjesmarres

nga vendet e BE-së për të mundësuar identifikimin e mekanizmave të zhvillimit dhe koordinimit të iniciativave të ndërtimit të kapaciteteve në rajon dhe për të mundësuar që produktet e projektit të jenë në përputhje me sistemin e informacionit mjedisor të përbashkët dhe me infrastrukturën për informim hapësiror në Europë.

IGJEUM, ka marrë pjesë aktive në projekt dhe ka realizuar të gjithë detyrimet. Këto janë paraqitur në raportet progresive në **Web-site të projektit BalkanGEONet**.

Është për tu përsëritur fakti që ky projekt ka krijuar një bashkëpunim shumë të ngushtë me projektin tjetër të rëndësishëm në kuadër të FP7, OBSERVE, që ka si objektivi forcimin dhe zhvillimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me vezhgimet në tokë për mjedisin në rajonin e Ballkanit. Ky projekt drejtohet nga Universiteti Aristotel në Greqi dhe Shqipëria është po ashtu partner.

Universiteti Politeknik i Tiranës dhe IGJEUM, është shumë i vëmendshëm ndaj të gjitha iniciativave që synojnë të përfshihen në projekte të rëndësishme ndërkombëtare dhe vecanërisht në iniciativat për të qenë partner në projektet në kuadër të FP (aktualisht FP7). Kështu, iniciativa të tilla do të kenë mbështetjen tonë pa rezervë.

Ju uroj punë të mbare!